

BJANKU: MESOJANI FEMIJEVE KENGET E BUKURA SHQIPTARE

Ne spektaklin me te rendesishem te vitit Miss Shqiptarja MB 2006 ishte edhe nje mysafir i veçante. Nuk ishte as veshja ekstravagante, as ardhja e tij nga Italia, qe e benin kete "mysafir te veçante" ne kete spektakel. Jo qe jane te pakte artistet shqiptare ne Angli por Ferdinand Bjanku duket se kishte veçantesine e tij.

Shpirti i tij prej artisti deshmohej edhe ne fjalet e mrekullueshme qe thote, edhe ne bisedat me miqte e ri qe ze.

Si nje nder aktivistet me te shuar shqiptar ne Itali, Ferdinand Bjanku e di shume mire se çdo te thote te organizosh nje spektakel, por eshte kenga qe transmetonte me se miri ate kumtin e artistit mërgimtar, kenga aq e duartrokitur nga publiku, kenga qe i dha nje nuance te mrekullueshme këtij spektakli.

Ndjehet teper i kenaqur qe ka marre pjese ne kete spektakel bukurie dhe pasi falënderon ALBA MEDIAN tregon ne nje interviste per jeten e tij artistike dhe planet per te ardhmen

Si ndjeheni pas pjesëmarrjes ne këtë spektakël bukurie?

Pas përfundimit te spektaklit te bukurisë kam ndjere pothuaj keqardhje qe kaq shkurt përfundoi, por ishte një eksperience kaq e madhe.

Ky eveniment ishte i rendesishem jo vetëm për komunitetin shqiptar qe jeton ne MB por edhe për ne artistet shqiptare qe morëm pjese. Ku përveç kenaqesise qe ngjallin këto spektakle kane edhe pergjegjesine e tyre.

Si ka nisur karriera juaj artistike?

Ndofta ka nisur qe me lindjen time. Babai im, qe sot fatkeqësisht nuk jeton me, ishte i apasionuar pas instrumentit te kitarës e këngës popullore shkodrane. Destinacioni im ndofta ishte shënuar qe me lindjen time. Tepër i vogël kam marre kitarën ne dore e kam jetuar mes tingujve te saj. Me pas diplomimi ne Liceun artistik "Preke Jakova", Shkodër për kitarë elektrike, klarinete, fizarmonike... Kam marre pjese ne te gjithë festivalet kombëtare e lokale për fëmijë, te asaj kohe e po kështu jam aktivizuar me Klubin e Rinise se Shkodres "Heronjtë e Vigut"

C'fare ishte për ju emigrimi dhe sa ndikoi ne krijimtarinë tuaj ?



Nuk ishin motivet ekonomike qe me shtynë te merrja rrugën e emigrimit. Por dëshira për te gjetur hapësira te reja edhe për krijimtarinë time. Jetën ne Itali e kam nisur ne Brindisi me synimin drejt Romes. Ne Rome për një periudhe kohe si te gjithë emigrantet kam kaluar kushte te vështira derisa një dite ka ardhur edhe arti.

Shume shpejt jam integruar ne artin italian. Tashme ne Itali kam krijuar profilin tim si kantautor, këngëtar dhe instrumentist. Ne Rome, kritika muzikore me ka cilësuar si "bretkosa qe u shndërrua ne princ". Kështu thuhet shprehimisht ne një nga revistat kulturore romane "Diario Romano". Ne Rome kam marre pjese ne konkursin e zërave te rinj te muzikës te lehte italiane, ku edhe kam arritur te marr çmimin e pare. Me pas sfida te tjera, konkurse e festivale.

Kenaqesine me te madhe ma kane dhënë dhe shfaqjet kur mijëra spektatore italiane këndojnë pa reshtur këngët e vendit tim. Sinqerisht, jam i kënaqur qe munda te këndoj ne Itali, Shqipërinë time, Shkodren time, te interpretoj këngët e artisteve me te njohur italiane dhe te paraqes këngët e mia. Si e arrij këtë? Duke shpërndarë tekstet e këngëve ne shqip dhe ne italisht kudo neper



salle dhe te gjithë te këndojnë këngët. Koncertet janë te shumta, konkurset muzikore dhe festivalet ku kam qene pjesëmarrës. Ne karrierën time artistike ka ndikuar shume edhe miqësia e shkëmbimi profesional me Roberto Giglio, me te cilin kam realizuar edhe Cd-te e mia me studion Bjanku-Giglio prodhimi muzikor ne Rome. Nder sukseset e fundit te koncerteve mund te përmend pjesëmarrjen ne Koncertin "A testa alta" me poezi muzike e këngë shqiptare ne Ist. SS. Annunziata, Poggio Imperiale, Firenze ku për here te pare ne Sallën e Bardhe ose Salla e Moxartit është dëgjuar kënga popullore shqiptare.



Ndërsa nder sukseset si autor kengesh - pjesëmarrjen ne Festivalin ndërkombëtar te zërave për fëmijë "Zecchino D'oro", Bolonje, nëntor 2005, ku përfaqësova Shqipërinë me këngën "Jam një zog shqiponje" e kënduar nga vogëlushja e talentuar nga Durrësi Joana

mirënjohje për artistët e pavdekshëm shkodranë, që na kanë lënë këtë trashëgimi të paçmueshme artistike.

Si u dashuruar me fotografinë?

Për një artist është pothuaj normale lëvrimi i fushave te ndryshme te artit. Kështu ndodhi me mua edhe me fotografinë, një pasion ndofta i fshehur qe ne fëmijëri gjeti kohet e tij te shfaqej. Është një investim i imi ne kohe për te njohur e perfeksionuar teknikat e fotografimit por edhe material, mbasi posedimi i aparateve te kohëve te fundit ndihmon ne realizimin perfekt te fotografisë.

Natyra, jeta e përditshme, shfaqjet artistike, ngjarjet e gëzueshme



Shtrepi, këngë e cila arriti ne finale.

Cfare mund te na thoni për krijimtarinë tuaj muzikore kur ju sapo keni publikuar një album te ri muzikor. Cila mendoni se është e veçanta e këtij albumi?

Natyrisht, puna e vazhdueshme ka sjelle si

kërkesë e si pasojë rritjen e nivelit te krijimtarisë sime. Këtë gjë e dëshmon edhe albumi i ri i fundit, i cili titullohet "Qytetit tim" volumi 2. Ne këtë album janë gjithsej 10 këngë. Të gjitha të mirënjohura, tituj këngësh e autorë. "Qytetit tim" (Alfred Çapaliku - Pjetër Gaci), "Margjelo" (Filip Ndocaj - Prengë Jakova), "Kur perëndon dielli", (Zef Leka - Leonard Deda), "Si dukat i vogël je"...

Kjo cd ishte një detyrim ndaj vendlindjes, ndaj të afërmeve të mi, miqve e dashamirësve, publikut. Shenjë

janë momente qe fshehin te bukuren dhe detyre e fotografit është te fiksoje këtë te bukur. Jam duke bashkëpunuar me fotografin e talentuar dhe te pa lodhur Artan Zeneli ku do te realizojmë një ekspozitë fotografike me disa ide dhe kompozime qe do realizojmë se shpejti. Përpiqem ...

A mund te na thoni diçka për planet tuaja te ardhmen?

Jam duke punuar për një tjetër Cd- po me kënge popullore shqiptare si dhe realizimi i koncerteve ne Itali, Shqipëri e vende te tjera ku jetojnë shqiptaret.

Cili është mesazhi juaj për lexuesit e gazetës sonë?

Secilit prej nesh i përket te ruaje e te trashëgojë zakonet e traditat tona mes tyre edhe këngët. Mësojuni fëmijëve tuaj këngët e bukura popullore shqiptare, ato janë baza e folklorit tone e traditave e zakoneve te bukura shqiptare.

Bisedoi Brunilda Sejati